



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

NJOFTIM PËR APLIKIM

Anëtar i Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 31 të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 37, datë 13.08.2013 “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 6, datë 15.04.2016 “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar”, si edhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 26, datë 28.12.2022 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar në qarkun Vlorë” si dhe të Vendimit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 01, datë 16.12.2022 (Nr. 2100 Prot, datë 16.12.2022 “Për krijimin e këshillit vendor të arsimit parauniversitar në qarkun Vlorë”, njoftojmë për aplikim për:

Anëtar të Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar

Kandidati për anëtar i Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar duhet të përmbushë këto kriterë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës prerë të gjykatës.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi, në ngarkim të tij.
- Të ketë jo më pak se dhjetë vjet përvojë drejtuese në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, si edhe të ketë përvojë pedagogjike në mësimdhënie.
- Të ketë, si autor i parë, botime, studime, vëzhgime, analizave etj., në fushën e edukimit.
- Të ketë marrë pjesë në simpoziume, kongrese, konferenca ose kërkime shkencore brenda dhe jashtë vendit në fushën e arsimit parauniversitar.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat (dosjen personale) si më poshtë:

- Kërkesën për shprehje interesi;
- Jetëshkrimin;
- Diplomë dhe listë notash të studimeve universitare dhe/ose pasuniversitare të njësuara me origjinalin;
- Listën e botimeve, vëzhgimeve, studimeve, raporteve dhe kopje të tyre në fushën e arsimit parauniversitar;
- Tri referenca nga institucione shtetërore ose organizata me të cilat ka bashkëpunuar për çështje të arsimit parauniversitar;
- Kopje të njësuara me origjinalin e librezës së punës;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

- Dëshmi penaliteti të 3 muajve të fundit nga data e kërkesës;
- Çmime, medalje, tituj, grada të dokumentuara (fotokopje) të marra për kontribute dhe arritje në fushën e arsimit parauniversitar.

Dokumentat duhet të dorëzohen përmes shërbimit postar apo pranë Zyrës së Protokollit – Arkivës, brenda datës 24.02.2023 në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra Protokoll - Arkivë, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të , Vlorë.

Komisioni i ngritur në nivel qarku do të vlerësojë dhe do të propozojë pranë Kryetarit të Këshillit të Qarkut kandidatët e përzgjedhur për anëtar të këshillit vendor të arsimit parauniversitar.

Për të gjithë hapat e kësaj procedure do të njoftoheni në faqen zyrtare të institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë.